



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna nga paragrafi 4 i nenit 63, paragrafi 5 i nenit 17 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr. 12/2024, i datës 25.12.2024, me datë 31/12/2024 merr këtë:

**V E N D I M**

- I.** Zbatohet vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr. 12/2024, i datës 25.12.2024, ashtu që certifikohet subjekti politik **SRPSKA LISTA** për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025, dhe kandidatëve të këtij subjekti politik, me gjithsejtë dyzetë e tetë (48) kandidatë në listë.
- II.** Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) obligohet që të njoftoj subjektin politik **SRPSKA LISTA**, për marrjen e këtij Vendimi.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e plotfuqishëm të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr. 12/2024 i datës 25.12.2024 është aprovuar si e bazuar ankesa e subjektit politik SRPSKA LISTA, me ç' rast, PZAP ka urdhëruar KQZ që ta certifikoj subjektin politik SRPSKA LISTA dhe kandidatët e këtij subjekti politik për Zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës që mbahen me datën 09.02.2025. Duke pasur parasysh se vendimi i PZAP është i detyrueshëm për tu zbatuar nga KQZ sipas nenit 118, par. 5 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 31.12.2024

